

## KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 11/08 2021 (dymijë e njezet e nje), palët e poshtëshënuara mblidhen për lidhjen e kësaj kontrate shitblerjeje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

**SHITËSI:** Z. Erlis Shkurti, shtetas italian, i datëlindjes 28/10/1983, lindur ne Tirane, identifikuar me Leternjoftimin me nr. I31028040U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë “Finance Group Softwer House” Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 27.07.2021, me NUIS: M11929017U;

**BLERËSI:** Z. Mauro Sica, shtetas italian, i datëlindjes 21/06/1978, lindur dhe banues në Itali, identifikuar me Leternjoftimin me nr. AA3116528, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### NENI 1

Shitësi është ortak me zotërues i 1 kuote, me pjesëmarrje 100% të kuotave, të shoqërisë “Finance Group Softwer House” Sh.p.k, regjistruar si person juridik në datën 27/07/2021, me NUIS: M11929017U, me seli në TIRANE Njësia Administrative Nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Ndërtesa Nr. 14, Pallati Nr. 4, Apartamenti Nr. 5..

1.1 Këto kuota të shoqërisë, Shitësi ia shet Blerësit te cilët pranojnë t'i blejnë ato sipas çmimit dhe kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

1.2 Nga këto kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë “Finance Group Softwer House” Sh.p.k që ai zotëron, Shitësi i shet Blerësit 100% të tyre, me vlerën e tyre të cilët pranojnë t'i blejnë ato, sipas kushteve dhe proporcionit të përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

### NENI 2

2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësit, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë “Finance Group Softwer House” Sh.p.k, është në vlerën e tyre nominale.

2.2 Ky çmim është likuiduar nga Blerësi kundrejt Shitësit, dhe Shitësi deklaron se e ka marrë këtë çmim dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tij ndaj Blerësit.

### NENI 3

3.1 Blerësi, i blen kuotat që shet Shitësi, në raportin e mëposhtëm:

**Mauro Sica**, blen 100% të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 100.000 Lekë, dhe bëhet ortak me 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “Finance Group Softwer House” Sh.p.k

Aplikant  
Blerësi

3.2 Me realizimin e kësaj shitblerje të 100% të kuotave të shoqërisë "Finance Group Software House" Sh.p.k, Blerësit i transferohen proporcionalisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në shoqëri.

**NENI 4**

4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ai i shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative, arbitrazhi apo të çfarëdo lloj natyre tjetër që të mund të jetë shkak për cënimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

**NENI 5**

5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.


5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata hartohet në 2 (dy) kopje me nga dy fletë, me të njejtën vlerë ligjore.

**PALËT KONTRAKTORE**

**SHITËSI**

Erlis Shkurti



**BLERËSI**

Mauro Sica